



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Nr. 18946 Prot

Shkodër, më 15.07.2026

Lënda: Dërgim për shqyrtim relacioni dhe projekt vendimi mbi “**Rregulloren e shfrytëzimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër**”.

KESHILLIT BASHKIAK SHKODER

Adresa : Rruga 13 Dhjetori, Nr.1

Të nderuar këshilltarë në mbështetje të dispozitave ligjore të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; VKM nr.408, date 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; të ndryshuar; Ligjit nr.68/2017, date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; VKM 224 datë 01.04.2026 “Për miratimin e rregullores së hapësirës shfrytëzimit të hapësirës publike” , bashkangjitur ju paraqesim për shqyrtim relacionin dhe Projekt - Vendimin mbi “ Rregulloren e shfrytëzimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër”.

Duke ju falenderuar !

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z/ KRYETAR

Alban PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 18446/1 Prot

Shkodër, më 15.07.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____/_____/2026

**“MIRATIMIN E RREGULLORES SË SHFRYTEZIMIT TË HAPËSIRËS
PUBLIKE NË BASHKINË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____/____/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 54 shkronja “k”, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; VKM nr.408, date 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; të ndryshuar; Ligjit nr.68/2017, date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; VKM 224 datë 01.04.2026 “Për miratimin e rregullores së hapësirës shfrytëzimit të hapësirës publike”

VENDOSI

1. Shfuqizimin e VKB nr.45 “Rregullore e përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër” datë 25.06.2025.
2. Të miratojë rregulloren e shfrytëzimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër”, sipas materialit bashkëngjitur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Alban PREKA

Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike

Altin SALIHI



Drejtorja e Përgjithshme Juridike, Burimeve

Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Griselda DAMA



Drejtorja e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

Dorina ISUFI



Drejtorja Juridike

Brikena LEQEJZA



Drejtorja e Tarifave dhe Taksave

Ardit BEHARI



Drejtorja e Përgjithshme
Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Mikel KAPSAJ



Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Dionis DRAGANI



Policia Bashkiake

Sajmir RRUSTEMI



Inspektoriati Mbrojtjes Territorit

Pjerin Lazri

*Me vendime delegimi
Sajmir RRUSTEMI*

Grupi i Punës : Ermela KRUIJA

Rasel TELI

Sabina HEBOVIA

Sandra KUKA

Blendi ÇELAJ

Ylbere DURRAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2026

RELACION

**MBI “MIRATIMIN E RREGULLORES SË SHFRYTEZIMIT TË HAPËSIRËS
PUBLIKE NË BASHKINË SHKODËR”**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Shkodër ka paraqitur materialin pranë Këshillit Bashkiak Shkodër, me objekt: Miratimin e rregullore së shfrytëzimit të hapësirës publike në bashkinë Shkodër.

Pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 224 datë 01.04.2026 , është krijuar një kuadër i ri normativ, i cili përcakton në mënyrë të detajuar parimet, rregullat, kriteret dhe procedurat për shfrytëzimin e hapësirave publike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Rregullorja aktuale e Bashkisë Shkodër është miratuar mbi bazën e legjislacionit të mëparshëm dhe për rrjedhojë përmban dispozita që nuk janë më në përputhje me aktin e ri normativ. Për të shmangur mbivendosjen e dispozitave, kërkohet shfuqizimi i saj dhe miratimi i një rregulloreje të re , në plotësim të kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 224 datë 01.04.2026.

Rregullorja e re ruan kompetencat e bashkisë në administrimin e hapësirës publike, duke i ushtruar ato në përputhje me standartet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar, si dhe duke marrë në konsideratë veçoritë dhe nevojat lokale.

Në vijim të nevojave dhe problematikave të hasura në rregullimin e kuadrit ligjor mbi hapësirat publike , ky projekt vendim konsiston në shfuqizimin e VKB nr.45 “Rregullore e përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër” datë 25.06.2025, dhe miratimin e rregullore së re të përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër”,

Sa më sipër theksojmë se qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve për një përdorim sa më uniform të hapësirës publike me qëllim krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit dhe sigurisë publike, nëpërmjet krijimit të një marrëdhënie transparente ndërmjet komunitetit dhe organeve autorizuese dhe inspektuese të Bashkisë Shkodër, me qëllim disponimin racional të burimeve të përbashkëta.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshua; VKM nr.408/201 “Për miratimin rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; të ndryshuar; Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, VKM 224 datë 01.04.2026 “Për miratimin e rregullores së hapësirës shfrytëzimit të hapësirës publike” ;

Së fundi propozojmë Këshillit Bashkiak

- **Shfuqizimin e VKB nr.45 “Rregullore e përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër” datë 25.06.2025**
- **Miratimin e “Rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër”.**

Duke ju falenderuar!

**ME VENDIM DELEGIMI
Z / KRYETAR
Alban PREKA**



**KRYETAR
Benet BECI**

Konceptoi:
Grupi i Punës :

Mikel Kapsaj
Dionis Dragani
Rasel Teli
Sabina Hebovija
Sandra Kuka
Ermela Kruja
Blendi Çelaj
Ylber Durraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

RREGULLORJA
E
PERDORIMIT SË HAPËSIRËS PUBLIKE
BASHKIA SHKODËR

Baza ligjore :

Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar

Ligji Nr. 68/2017, date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar

Ligji Nr. 9632, date 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, të ndryshuar

Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; të ndryshuar

Ligji Nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar

VKM 224 date 01.04.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike.

VKM 408 date 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”i ndryshuar.

Përmbajtja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA SHKODËR.....	1
Baza ligjore :	2
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	5
Neni 1 - Objekti dhe qëllimi.....	5
Neni 2 - Përkufizime	5
Neni 3 – Përgjegjësitë e Bashkisë	6
Neni 4 – Funksionet e strukturës përgjegjëse për kontrollin e hapësirës publike	7
Neni 5 – Përgjegjësitë e strukturave të Bashkisë	7
Neni 6 – Autoritetet e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.....	8
Neni 7 – Strukturat e sigurisë dhe emergjencave	8
Neni 8 - Procedura e aplikimit dhe leja përkatëse.....	8
Neni 9 – Raporti me legjislacionin sektorial	9
çështjet që lidhen drejtpërdrejt me shfrytëzimin dhe administrimin e hapësirave publike.	9
Neni 10 - Afati i lejes për përdorimin e hapësirës publike.....	9
Neni 11 - Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat.....	9
Neni 12- Ndalimet.....	10
Neni 7 - Mirëmbajtja dhe dëmtimet	10
Neni 13 - Kthimi i hapësirës publike	11
Neni 14 - Masat ndëshkuese	12
Neni 15 - Detyrimet financiare.....	13
Neni 16 - Të tjera	13
KREU I - PERDORIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E AKTIVITETEVE RESTORATIVE DHE/OSE REKREATIVE.....	14
Neni 17 - Leja për hapësirën publike	14
Neni 18 - Afati, dokumentacioni dhe procedura aplikimit.....	14
Neni 19- Tipet e pajisjeve të lejuara.....	15
Neni 20 - Tendat me strehë	15
Neni 21- Tendat diellore	16
Neni 22 - Çadrat e diellit.....	16
Neni 23 - Lojërat për fëmijë.....	16
KREU II - DISTANCAT QË DUHET TË RESPEKTOHEN	17
Neni 24 - Distanca.....	17
KREU III - EKSPOZIMI I MALLRAVE JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT	17
Neni 25 - Leja dhe procedurat e dhënies së lejes	17

KREU IV – PARKIMET E AUTOMJETEVE	18
Neni 26 - Krite mbi Parkimet e Rezervuara të automjeteve	18
KREU V – PARKIMET E BIÇIKLETAVE.....	20
Neni 27 - Krite mbi vendosjen e Parkimeve të Biçikletave	20
Neni 28 - Autorizimi dhe procedura e dhënies së tij.....	21
KREU VI - DISPOZITA TË FUNDIT	22
Neni 29 - Dispozita kalimtare	22
Neni 30 - Hyrja në fuqi	22
LIDHJA A.....	23
Neni 1 - Përcaktime mbi çadrat e diellit që lejohen	23
Format e Lejuara të Çadrave: Tipi 1 – E varur, me krah	23
Ngjyrat e lejuara të Strukturës së Çadrës:	24
Ngjyrat e lejuara të Pëlhurës së Çadrës:.....	24
Neni 2 - Përcaktime mbi tendat me strehë dhe tendat diellore që lejohen.....	27
Materialet e tendës duhet të jenë pëlhurë beze, pëlhurë akrilike, pvc; me ngjyrat e lejuara si më poshtë:	27
Neni 4 - Ekspozitorë produktesh ushqimore	29
Neni 5 - Modele ekspozitorë veshje.....	31
Neni 6 - Biçikletat	31

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e zënies/përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë e Shkodrës, në plotësim të kriterëve të përcaktuara sipas VKM 224, datë 01.04.2026 “Për Miratimin e Rregullores së Shfrytëzimit të Hapësirës Publike”.
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve për një përdorim sa më uniform të hapësirës publike me qëllim krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit dhe sigurisë publike, nëpërmjet krijimit të një marrëdhënie transparente ndërmjet komunitetit dhe organeve autorizuese dhe inspektuese të Bashkisë Shkodër, me qëllim disponimin racional të burimeve të përbashkëta.
3. Rregullorja përcakton procedurat për dhënien e përdorimit të hapësirës publike, sipas kategorisë së aktivitetit që do të ushtrohet nga subjekti/et e interesuar dhe pajisjeve që do të lejohen të përdoren në një hapësirë publike të caktuar.

Neni 2 - Përkufizime

Për qëllime të aplikimit të kësaj rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“**Hapësirë publike**” është hapësira e jashtme, si: trotuari, rruga, sheshi, kënde lojërash për fëmijë, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise, që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar.

1. “**Shërbimet e lejuara**”, shërbimet që autoriteti vendor lejon të kryhen në hapësirë publike, sipas kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, që përputhen me ndërtimet rreth hapësirës ku ato krijohen, sipas ligjit dhe dokumenteve të planifikimit.
2. “**Mobilimi urban**”, procesi i projektimit, ndërtimit dhe/ose vendosjes në hapësirë publike të objekteve apo ndërtimeve të lëvizshme ose jo, me qëllim përmirësimin e cilësisë funksionale dhe estetike të saj, rritjen e sigurisë publike dhe, sipas rastit, reduktimin e trafikut. Objektet e mobilimit urban përfshijnë vegjetacion, shtresat në sipërfaqen e hapësirave publike, stola, shatërvanë, instalime artistike, skulptura, tabela për emërtime të rrugëve apo reklamime, kabina telefonike, kosha për mbeturina, ndriçues, semaforë, trarë dhe objekte kufizimi të parkimit ose për ngadalësimin e automjeteve, kuti postare etj.
3. “**Aktivitete rekreative dhe restorative**”, përfshihen por pa u kufizuar aktivitete si, baret, restorantet, piceri, fast-food, hoteleri, si dhe çdo shërbim tjetër që ushtrohet në sektorin e shërbimeve sociale.
4. “**Kioskë**”, është një strukturë e vogël dhe pa themele, me materiale të çmontueshme, në të cilën shiten artikuj si pije, cigare dhe sende të tjera të ngjashme kinkalerie, përfshirë revistat apo gazetatat.
5. “**Trotuar**”, është zona ndërmjet objekteve dhe karrexhatës që përdoret për aksesin e këmbësorëve. Gjërësia nga fasada e objektit deri në fundin e bordurës së trotuarit.

6. **“Bordura”**, është element i parë që ndan karrexhatën me trotuarin.
7. **“Element Urban”**, është zona në të cilën bëjnë pjesë elemente si pemë në krah të trotuarit, gjelbërim apo shkurre, koshat e mbeturinave, reklamat, ndriçuesit rrugor, stolat , vendqëndrimet e biçikletave etj.
8. **“Zonë Lëvizëse”**, është hapësira publike që lejon kalimin e këmbësorëve në mënyrë lineare, paralel me karrexhatën dhe pa ndërprerje e cila duhet të jetë e lirë gjithmonë.
9. **“Frontazhi”**, është hapësira publike përpara fasadës së objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomik. Pajisjet e përcaktuara më lart duhet të vendosen brenda zonës së frontazhit për të cilën jepet leja.
10. **“Njësi tregtimi”** është ambienti i mbyllur njesi/dyqan në të cilin subjekti kryhen aktivitetin e tij. Njësitë e tregtimit mund të jenë të shkëputura nga ndërtesa ose mund të përfshihet në të.
11. **“Me pajisje”**, kuptohen struktura metalike, plastike ose druri të cilat shërbejnë për ekspozimin e mallit përpara njësisë së tregtimit.

Neni 3 – Përgjegjësitë e Bashkisë

1. Bashkia është organi përgjegjës për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore dhe legjislacionin sektorial në fuqi. Aplikimi për leje për shfrytëzimin e hapësirës publike kryhet nëpërmjet portalit “e-Albania”.
2. Drejtoria e Plamifikimit dhe Zhvillimit të Territorit është struktura përgjegjëse në bashki e cila informon dhe mbështet kryetarin e bashkisë dhe këshillin bashkiak në ushtrimin e kompetencave të tyre.
3. Bashkia harton dhe miraton skemat e organizimit për tregje, panairë dhe aktivitete të tjera të përkohshme, nëpërmjet strukturave përkatëse të saj.
4. Bashkia administron dhe mbikëqyr hapësirat publike në territorin e saj, në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës publike, hapësirave të gjelbra dhe elementeve të tjera urbane.
5. Bashkia përdor Regjistrin Elektronik Unik për lejet dhe pagesat që lidhen me shfrytëzimin e hapësirave publike brenda territorit të saj administrativ, i cili përditësohet në kohë reale dhe është i aksesueshëm për strukturat zbatuese. Ky regjistër ndërvepron me sistemet online të institucioneve të tjera përkatëse.
6. Bashkia përgatit dhe publikon raporte periodike, të paktën një herë në vit, mbi gjendjen e hapësirave publike, shfrytëzimin e tyre dhe të ardhurat nga tarifat. Këto raporte publikohen në faqet zyrtare të çdo bashkie, në seksionin përkatës.
7. Bashkia, përmes IMT-së si strukturë inspektimi, kryen kontrolle për të verifikuar respektimin e kushteve të lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike.
8. Qytetarët kanë të drejtë të paraqesin ankesa dhe sugjerime mbi përdorimin dhe administrimin e hapësirave publike, të cilat regjistrohen dhe trajtohen përmes sistemit elektronik unik.
9. Bashkia bashkëpunon me institucione të tjera publike për mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve që lidhen me fushat e tyre të përgjegjësisë.
10. Bashkia publikon hartën interaktive të hapësirave publike të dhëna me leje, përfshirë afatet dhe tarifat përkatëse.

Neni 4 – Funksionet e strukturës përgjegjëse për kontrollin e hapësirës publike

1. IMT-së si strukturë inspektimi për kontrollin e hapësirave publike mbikëqyr zbatimin e kësaj rregulloreje dhe evidenton rastet e shfrytëzimit pa leje ose në kundërshtim me kushtet e lejes.
2. Për çdo shkelje të konstatuar, struktura harton procesverbale zyrtare, sipas formateve të miratuara nga bashkia, dhe i regjistron ato në sistemin përkatës.
3. IMT-ja për kontrollin e hapësirave publike i përcjell rastet e shkeljeve pranë sektorëve përgjegjës në bashki, sipas natyrës së shkeljes.
4. Në rastet kur pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve, Policia Bashkiake ndërhyr menjëherë për heqjen e barrierave dhe caktojnë afat për korrigjimin e shkeljes.
5. Struktura përgjegjëse për kontrollin e hapësirave publike zbaton urdhrat e kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak për pezullimin ose revokimin e lejeve.
6. IMT-së si strukturë inspektimi për kontrollin e hapësirave publike bashkëpunon me Policinë Bashkiake për ndërhyrje të menjëhershme dhe për ekzekutimin e masave administrative. Në rast rezistence ose rreziku për rendin publik, kërkohet ndihma e strukturës shtetërore për rendin publik.

Neni 5 – Përgjegjësitë e strukturave të Bashkisë

1. Strukturat përgjegjëse të bashkisë ushtrojnë funksionet e mëposhtme:

- a) Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit kontrollon përputhshmërinë e projekteve të paraqitura me dokumentet e planifikimit, rregulloret e veçanta në fuqi, përfshirë edhe hartën e hapësirave publike, dhe jep opinion teknik.
 - b) Ndërmarrja e Punëve dhe Shërbimeve Publike menaxhon shërbimet që ofrohen në hapësirat publike dhe monitoron zbatimin e kushteve të lejeve dhe kontratave të shfrytëzimit. Gjithashtu siguron pastrimin, gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike
 - c) Struktura përgjegjëse për pastrimin dhe gjelbërimin siguron pastrimin, gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike.
 - ç) Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore mbledh tarifatat dhe të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirës publike.
 - d) Drejtoria Juridike:
 - i. siguron asistencë juridike për hartimin e kontratave dhe procedurave përkatëse;
 - ii. monitoron zbatimin e lejeve e të kontratave dhe mbështet procedurat ligjore në rast shkeljesh.
2. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit raporton periodikisht të kryetari i bashkisë dhe informojnë këshillin bashkiak mbi aktivitetin dhe problematikat në menaxhimin e hapësirave publike.

Neni 6 – Autoritetet e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit

1. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU) është organi vendimmarrës për lejet e zhvillimit e të ndërtimit dhe akte të tjera, sipas përcaktimeve të ligjit nr.107/2014, “për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.
2. IMT shërben si strukturë përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje dhe për evidentimin e rasteve të shfrytëzimit pa leje ose në kundërshtim me kushtet e lejes, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe legjislacionin për inspektimin.
3. Për hapësirat publike të krijuara si pasojë e lejeve të ndërtimit të lëshuara nga KKTU-ja, IMT-ja bashkërendon procesin e kontrollit me sekretariatit teknik të KKTU-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7 – Strukturat e sigurisë dhe emergjencave

1. Policia Bashkiake si përgjegjëse për rendin publik, në zbatim të legjislacionit sektorial, ushtron funksionet e saj për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, si dhe për zbatimin e ligjit gjatë aktiviteteve në hapësira publike, në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.
2. Policia Bashkiake në zbatim të legjislacionit sektorial, ushtron funksionet e saj për garantimin e sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjen e punëve publike, miradministrimin e hapësirave publike dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e juridiksionit të saj.

Neni 8 - Procedura e aplikimit dhe leja përkatëse

1. Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë aktivitet në hapësirat publike duhet të pajiset me leje nga strukturat përkatëse të Bashkisë Shkodër.
2. Nëse subjekti kërkon leje për një hapësirë publike në një zonë me vlera monumentale, kjo leje do të lëshohet në bashkëpunim/bashkërendim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas nenit 12, pika 7 të VKM 224, datë 01.04.2026 “Për Miratimin e Rregullores së Shfrytëzimit të Hapësirës Publike”.
Paraprakisht duhet të merret konfirmimi/miratimi zyrtarisht nga i interesuari nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, (sipas dokumentacionit të nevojshëm) mbi sipërfaqen publike të cilën kërkon të perdori.
3. Afatet për shqyrtimin e kërkesave ndryshojnë në varësi të kategorisë së aktivitetit dhe lejes së kërkuar, por në çdo rast nuk tejkalohet afati 30 ditor nga momenti i marrjes së aplikimit.
4. Nëse gjatë shqyrtimit të aplikimit subjekti i interesuar ndryshon qëndrim, subjekti duhet t’ia komunikojë atë strukturës përkatëse në Bashkinë Shkodër brenda afatit të shqyrtimit të kërkesës, në të kundërt, subjekti është i detyruar të realizojë të gjitha detyrimet ndaj Bashkisë Shkodër).
5. Subjekti është i detyruar që lejen/kontratën e lëshuar nga Bashkia Shkodër ta ketë të vendosur në një vend të dukshëm në rastet kur kemi të bëjmë me zënie të hapësirës publike të qëndrueshme. Në të kundërt, të ketë lejen kurdoherë me vete nëse zënia e hapësirës publike kryhet në mënyrë jo të qëndrueshme.
7. Leja për ushtrimin e aktivitetit lëshohet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë shfrytëzimit të hapësirës publike dhe pronës së paluajtshme të shtetit.

Neni 9 – Raporti me legjislacionin sektorial

1. Çdo aktivitet, që ushtrohet në hapësirat publike, duhet të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit, ndërtimit, sigurisë rrugore, shëndetit publik, turizmit, trashëgimisë kulturore, rendit dhe sigurisë publike, tregtisë dhe shërbimeve, mbrojtjes civile dhe emergjencave, infrastrukturës teknike, me legjislacionin për garantimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe me çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor në fuqi.
2. Në rast mospërputhjeje midis kësaj rregulloreje dhe legjislacionit sektorial në fuqi, zbatohet legjislacioni sektorial.
3. Kjo rregullore zbatohet për atë sa legjislacioni sektorial nuk rregullon në mënyrë të posaçme çështjet që lidhen drejtpërdrejt me shfrytëzimin dhe administrimin e hapësirave publike.

Neni 10 - Afati i lejes për përdorimin e hapësirës publike

1. Ushtrimi i aktivitetit në hapësirat publike është i përkohshëm. Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit përcaktohet në varësi të kategorisë së aktivitetit që subjekti kërkon të ushtrojë. Për disa kategori të caktuara (*si aktivitete sociale, kulturore, panairë, citylight etj ...*) ushtrimi i aktivitetit në hapësirën publike mund të jetë i kufizuar vetëm në ditë apo në orë të caktuara, sipas VKM 224, datë 01.04.2026.
2. Afati maksimal për kohëzgjatjen e lejes për ushtrim aktiviteti është deri në një vit. Keshilli Bashkiak miraton dhënien e lejes për shfrytëzimin e hapësirave publike në rastet kur afati i kërkuar nga aplikuesi është mbi 1 (një) vit, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Miratimi kryhet në përputhje me tarifat e miratuara dhe mbi bazën e raporteve të hartuara nga sektorët përgjegjës për shqyrtimin shqyrtimin e aplikimeve në bashki.
3. Rinovimi i lejes nuk është automatik dhe bëhet pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të lejes së mëparshme, shlyerjes së detyrimeve financiare dhe respektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje. Kërkesa për rinovim paraqitet të paktën 3 muaj para përfundimit të afatit të lejes.

Neni 11 - Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat


1. Lejohet vetëm përdorimi i pajisjeve të përcaktuara në lejen/kontratën për zënien e hapësirës publike. Subjektet janë të lirë të zgjedhin format, materialet dhe ngjyrat e tyre në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe kërkesat estetike të përcaktuara nga Bashkia Shkodër.
2. Pajisjet duhet të jenë lehtësisht të çmontueshme + të sigurt për përdorim publik dhe nuk duhet të kenë pamje estetike të konsumuar/amortizuar dhe të çrregullt.
3. Në zona me rëndësi të veçantë social-kulturore apo ekonomiko-administrative, në të cilat synohet të kultivohet dhe ruhet një estetikë urbane uniforme, përdorimi i formave, materialeve dhe ngjyrave specifike për pajisjet nga subjektet e interesuar mund të përcaktohet me urdhër dhe vendime të titullarit të institucionit.
4. Nëse me akte ligjore të titullarit të institucionit ndryshojnë format, përmasat apo ngjyrat e pajisjeve në një zonë të caktuar, atëherë pajisjet duhet të ndryshohen sipas udhëzimeve të saj pa pasur nevojë për një leje të re. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit mbarë detyren e njoftimit ku kanë për detyrë t'ia komunikojë këtë subjekteve, ndërsa subjektet kanë për detyrë të bëjnë ndryshimet me shpenzimet e tyre në një kohe të caktuar por jo më shumë se 30 dite.

Neni 12- Ndalimet

Ndalohet zënia/perdorimi i hapësirës publike në rastet kur:

1. Pengon qarkullimin normal të këmbësorëve dhe automjeteve dhe cenon sigurinë publike, në buzë të trotuarit që korrespondon me vazhdimin e vijave të bardha për lëvizjen e këmbësorëve;
 2. zhvillohet në një distancë më të vogël se 3 (tre) m nga rampat ose shkallët e aksesit;
 3. Në ishujt e trafikut. Përrjashtime bëjnë ato raste në të cilën kjo nuk përbën asnjë shqetësim dhe nuk cenohet siguria për lëvizjen e këmbësorëve dhe atë të automjeteve;
 4. Në vendndalimet dhe vendqëndrimet e përcaktuara për mjetet e transportit publik;
 5. Në rastet kur bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore;
 6. Dëmton/cënon dekorin e qytetit;
 7. Nuk përmbush normat higjeno-sanitare;
 8. Bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
 9. Bie në kundërshtim me distancën e sigurisë nga stacionet e karburantit, që gjithsesi nuk mund të jetë më pak se 5 m distancë nga to.
 10. Në vendet që ka monumente duhet lënë një hapësirë e nevojshme, e cila të mos e pengojë/cenoje shikimin vizual te plote te monumentit sipas VKM 224, datë 01.04.2026.
1. Në zonat me vlera historike me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm në rastet kur garantohet një lëvizje e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në kryqëzimet në të cilët nuk ka semaforë zënia e hapësirës publike mund të bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit, pra të mos përbëjë asnjë vështirësi vizuale me qëllim sigurinë e lëvizjes së automjeteve, mjeteve pedaluese, këmbësorëve.



Neni 7 - Mirëmbajtja dhe dëmtimet

Subjekti, i cili është pajisur me leje për zënien e hapësirës publike, duhet:

1. Të garantojë një përdorim të sigurtë të hapësirës publike për kalimtarët, në përputhje me dekorin e qytetit dhe në gjendje të përshtatshme higjeno-sanitare.
2. Të mirëmbajë pajisjet, të cilat duhet të jenë gjithnjë në rregull dhe të pastra dhe të mos të mbaj apo të vendosi apo ekspozojë asnjë send tjetër, përveç asaj të miratuar në lejen për ushtrim aktiviteti (*si kutia ambalazhi, etj*).
3. Të sigurojë mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e pajisjeve, në rast të kundërt ndaj tij do të merren masa deri në anulimin e lejes së dhënë.
4. Çdo dëm që i shkaktohet hapësirës publike apo qytetarëve nga aktiviteti që zhvillohet, do t'i faturohet subjektit i cili është i pajisur me leje.

Dëmi ekonomik, si dëmtim në trotuar/infrastruktura, pemë apo hapësirën e gjelbër, vlerësohet mbi bazën e aktit të konstatimit nga Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në përputhje me aktet ligjore të miratuara për këtë qëllim.

Neni 13 - Kthimi i hapësirës publike

1. Hapësira publike duhet të lihet e lirë nga çdo pajisje në rastet kur strukturat përkatëse të Bashkisë Shkodër duhet të kryejnë punime për interes publik, ose punime mirëmbajtje.
2. Struktura përkatëse e Bashkisë Shkodër e cila planifikon ndërhyrjen e investimit të paktën 10 ditë para fillimit të punimeve, duhet t'i komunikojë subjektit me shkrim datën në të cilën hapësira duhet lënë e lirë.
3. Kur hapësira publike duhet lënë e lirë në mënyrë urgjente (në rastet e ndërhyrjeve në interes publik emergjent), komunikimi nga ana e strukturave përkatëse mund të bëhet në mënyrë verbale duke konfirmuar në vijim e pa vonesë në formë të shkruar.
4. Kundërshtimi i punonjësve të Bashkisë Shkodër sipas pikes 3 të nenit 8, përbën kundravajtje administrative.

Kur nuk është i mundur komunikimi verbal (*aktiviteti është mbyllur*), në këtë rast punonjësit e Policisë Bashkiake në bashkëpunim me strukturat përkatëse të shërbimeve pranë Bashkisë Shkodër kryejnë lirimin e territorit dhe koston e punimeve ia faturojnë subjektit.

5. Hapësira publike duhet të kthehet në gjendjen e saj të mëparshme në rastet kur:

- a) subjekti nuk është i lejuar të ushtrojë aktivitetin;
- b) kalon data e përfundimit të lejes;
- c) anulohet leja/autorizimi.

5. Nëse lirimi i saj nuk bëhet nga vetë subjekti, struktura përgjegjëse inspektuese IMT në bashkëpunim me Policinë Bashkiake marrin masa për lirimin e hapësirës publike dhe të gjitha shpenzimet për lirimin e saj i faturohen subjektit përgjegjës. Lirimi i hapësirës publike mbështetet nga strukturat përgjegjëse të bashkisë Shkodër për asistencën me mjete, burime njerëzore si dhe informacion mbi fashat kohore të miratuara të hapësirave publike.

Neni 14 - Masat ndëshkuese

1. Në të gjitha rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje nga subjekti i interesuar të kushteve të përcaktuara në lejen për zënie e hapësirës publike, ndaj subjektit të interesuar do të merren masat administrative , si më poshtë:

- a) Paralajmërim me shkrim/akt konstatimi;
- b) Gjobë;
- c) Pezullim;
- d) Shfuqizimi i lejes.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, konsiderohen shkelje:

- a) Zënia e hapësirave publike pa u pajisur më parë me lejen përkatëse;
- b) Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në lejen që i është dhënë;
- c) Instalimi i pajisjeve që nuk janë të përfshira në lejen përkatëse;
- d) Kur mosmirëmbajtja e pajisjeve dëmton/cenon dekorin e qytetit ose përbën rrezik për jetën dhe sigurinë e qytetarëve;
- e) Subjekti nuk mban pastër hapësirën e cila i është lënë në dispozicion;
- f) Subjekti nuk paguan tarifën për përdorimin e hapësirës publike brenda afateve të përcaktuara në leje;
- g) Subjekti prish qetësinë publike apo ka sjellje që çënojnë rendin dhe qetësinë publike, të konstatuara sipas akteve ligjore në fuqi.
- h) Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo anulimit;
- i) Kur zënia/përdorimi e kryer nuk është në përputhje me kriteret që janë përcaktuar në lejen e dhënë .
- j) Raste të tjera që nuk janë përfshirë në këtë nen, por që janë të parashikuara si shkelje ndaj hapësirës publike në akte të tjera ligjore/nënligjore në fuqi.

3. Për çdo shkelje të konstatuar apo dëmtim i hapësirës publike do të merret masat administrative dhe gjobë sipas akteve ligjore, nënligjore në fuqi.

4. Për shkeljet e përsëritura dhe të gjobitura për më tepër se tre herë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore merr masën e pezullimit të aktivitetit deri në korrigjimin e mangësive të konstatuara. Pezullimi jepet për një periudhë maksimale prej 30 ditë.

5. Nëse subjekti nuk ndërmerr masat e nevojshme për të korrigjuar mangësitë e konstatuara brenda periudhës së pezullimit, struktura përgjegjëse inicion dhe ndjek procedurën e plotë deri në pezullimin ose ndërprerjen e kontratës/lejes së dhënë në bazë të konstatimeve të evidentuara.

6. Për secilën nga shkeljet e konstatuara masat ndëshkuese janë të integruara/kumulative, sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes. Masat për çdo shkelje do merren sipas procedurave të ndjekura nga organet inspektuese konform kësaj rregullore dhe ligjeve në fuqi.

7. Policia Bashkiake në rastet kur ka zënë abuzive konstaton shkeljen dhe merr masat sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nëse subjekti nuk respekton afatin, atëherë punonjësit e Policisë Bashkiake në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në bashki, do të realizojnë procedurën për të liruar hapësirën e zënë, ndërsa kostot përkatëse i ngarkohen subjektit përgjegjës.

Neni 15 - Detyrimet financiare

1. Dhënia e çdo leje për zënie e hapësirës publike kushtëzohet nga pagesa e tarifës së përcaktuar "Për Taksat e Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër e cila varion në bazë të zonës në të cilën subjekti zhvillon aktivitetin e tij dhe sipërfaqen e hapësirës publike të zënë në "m²".
2. Procedurat e pagesave bëhen pranë strukturës përgjegjëse për taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Shkodër.

Neni 16 - Të tjera

1. Lejohet që subjekti të vendosë pajisje reklamuese për produktet ose shërbimet që ofron vetëm pasi ai të jetë pajisur me lejen përkatëse nga struktura përgjegjëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Informacionet e nevojshme që do t'i shërbejnë subjekteve mbi kategoritë e aktiviteteve që zhvillohen në hapësirat publike ato mund t'i gjejnë në:
 - a) Në materialet promovuese;
 - b) Në buletine;
 - c) Në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër.

KREU I - PERDORIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E AKTIVITETEVE RESTORATIVE DHE/OSE REKREATIVE

Neni 17 - Leja për hapësirën publike

Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të zhvillimit të aktiviteteve restorative dhe/ose rekreative duhet të pajiset me kontratën përkatëse të shfrytëzimit të hapësirës publike si edhe me lejen perkatese për rastet kur punimet kërkojnë pajisjen me deklaratë paraprake.

Neni 18 - Afati, dokumentacioni dhe procedura aplikimit

1. Afati maksimal për kohëzgjatjen e lejes për ushtrim aktiviteti është deri në një vit. Keshilli Bashkiak miraton lejet për shfrytëzimin e hapësirave publike në rastet kur afati i kërkuar nga aplikuesi është mbi 1 (një) vit, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Miratimi kryhet në përputhje me tarifat e miratuara dhe mbi bazën e raporteve të hartuara nga sektorët përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve në bashki.

2. Subjektet aplikues, përveç dokumentacionit administrativ, duhet t'i përmbahen rregullave për plotësimin e dokumentacionit teknik/hartografik, që kanë të bëjnë me planvendosjen ose planimetritë dhe fotot e njësive ku ato zhvillojnë aktivitetin e tyre.

Aplikimi paraqitet në seksionin “e-Albania” dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për aplikim sipas formularit tip;
- b) Genplanin që pasqyron gjendjen ekzistuese dhe atë të propozuar, i pajisur me legjendën përkatëse dhe i integruar në kontekstin urban;
- c) Planimetrinë, pamjet dhe prerjet e projektit, të firmosura dhe të vulosura nga projektues të licencuar;
- ç) Licencën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale të projektuesit të dokumentacionit teknik;
- d) Fotografitë e gjendjes ekzistuese, ku paraqitet qartë konteksti urban;
- dh) Vizualizime grafike (rendera) të projektit të propozuar;
- e) Dokumentin që provon pronësinë ose qiranë e objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomik;
- ë) Dokumentin e identifikimit të subjektit (NIPT).
- f) Vendimin që subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara ndaj administratës.
- g) Në rastet kur parashikohet vendosja e karrigeve, subjekti është i detyruar të depozitojë një deklaratë noteriale, ku të përcaktojë mbjelljen e 1 peme për tavolinë, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin sektorial në fuqi, duke kontribuar në rritjen e fondit të gjelbërimit të bashkisë.

3. Struktura përgjegjëse kryen vlerësimin paraprak të dokumentacionit brënda 7 ditëve dhe njofton subjektin për cdo mungesë. Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimarrja përfundimtare realizohen brënda 15 ditëve kalendarike nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të plotë. Pas miratimit të aplikimit, bashkia lëshon faturën për pagesën e tarifës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Lejet për ushtrim aktiviteti jepet vetëm pasi janë marrë miratimet dhe autorizimet përkatëse për sa më sipër, si dhe në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.
5. Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike, së bashku me genplanin/planimetrinë, afishohet nga subjekti në një vend të dukshëm.

Neni 19- Tipet e pajisjeve të lejuara

1. Në hapësira publike të parrethuara, njësi e hapur, lejohen të vendosen pajisjet si më poshtë:

- a) Tavolina, karrige;
- b) Çadra dielli;
- c) Tenda me strehë;
- d) Tenda diellore të mbyllshme;
- e) Lojëra për fëmijë.

Paisjet si tenda me strehë, tenda diellore të mbyllshme lejohen vetëm sipas modelit të mobilimit urban të parashikuara në këtë rregullore.

2. Kushtet dhe kriteret që zbatojnë subjektet që pajisen me lejen për zënien e hapësirës publike në lidhje me vendosjen e tipeve të ndryshme të pajisjeve në hapësirat publike janë të përcaktuara në nenet në vijim dhe sipas Vkm 224 datë 01.04.2026.
3. Forma, materialet dhe ngjyrat e tavolinave janë në diskrecion të plotë të subjektit që pajiset me leje, përveç rasteve kur me urdhër dhe vendime të Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme e specifike për zonën të kushtezuara nga akte ligjore të tjera të cilat nuk përfshihen në këtë rregullore.

Neni 20 - Tendat me strehë

1. Tenda me strehë është struktura që përbëhet nga materiale sintetike apo pëlhura tekstili, të vendosura në pjesën e jashtme të njësisë, pa pikëmbështetje në truall, që shërbejnë për mbrojtjen nga dielli, reshtje e shiut apo shkaqe të tjera si pasojë e motit të keq.
2. Tendat duhet të vendosen për çdo vitrinë në mënyrë të veçantë, duke u përshtatur dhe me fasadën e ndërtesës. Tendat nuk duhet të jenë të puthitura me fasadën. Në rastin kur fasadat paraqesin veshje të veçanta në tullë, gurë ose materiale të tjera me vlerë, ndalohen instalimet që shkaktojnë tjetërsim të fasadës apo elementëve të dekorit.
3. Është i lejueshëm reklamimi pasi të jetë marrë autorizimi për këtë qëllim nga organi kompetent. Reklama duhet të vendoset në ekstremin e poshtëm të tendës me një madhësi të rregullt dhe të harmonizuar.
4. Gjatë periudhës së mbylljes së aktivitetit, tendat me strehë të cilat janë të dala më shumë se 1 m nga fasada nuk duhet të jenë të hapura.
5. Forma e tendës është në diskrecion të subjektit që pajiset me leje, përveç rasteve kur me akte të Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme dhe specifike për zonën. Materialet dhe ngjyrat e përdorura për tendën duhet ti përmbahen atyre të paraqitura në Lidhjen A.

Neni 21- Tendat diellore

1. Tendat diellore janë struktura me mbulesë sintetike ose pëlhurë projektuar me pikëmbështetje mbi truall.
2. Tendat diellore nuk duhet të bllokojnë fushën e shikimit. Ndalohen të gjitha mbylljet ballore dhe anësore. Strukturat duhet të jenë rezistente ndaj erërave. Për këtë duhet të jenë të fiksuara mirë në truall në mënyrë që të mos përbëjnë asnjë rrezik për kalimtarët dhe të mos cenojnë sigurinë dhe jetën e njerëzve.
3. Me përjashtim të rasteve kur me akte të Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme e specifike për zonën , materialet dhe ngjyrat e përdorura për tendën duhet ti përmbahen atyre të paraqitura në Lidhjen A.
4. Në qendrat historike, për sa i përket ngjyrave, do të mbahen parasysh karakteristikat e veçanta të objektit në fjalë.

Neni 22 - Çadrat e diellit

1. Çadra dielli janë strukturat mbajtëse me mbulesë beze të instaluar vetëm në një pikëmbështetje në truall.
2. Projektimi në truall i çadrave të diellit nuk duhet t'i kalojë limitet e sipërfaqes së dhënë në leje.
3. Lejohen shkrime publicitare, parashikuar në lejen e dhënë për reklamë, në pjesën e jashtme të çadrave. Këto reklama duhet të kenë një karakter të pranueshëm për zonën dhe ambientin ku do të vendosen këto çadra.
4. Çadrat diellore duhet të vendosen në bazamente të posaçme. Lartësia e telave të çadrës duhet të ketë një lartësi minimale prej 2.2 metra nga trualli.
5. Në rastet kur moti i keq shoqërohet me erëra të forta apo stuhi, çadrat diellore duhet të jenë të mbyllura, duke mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e njerëzve. Gjatë natës, çadrat e diellit duhet të mbyllen ose të largohen nga hapësira publike e zënë.
6. Materialet dhe ngjyrat e përdorura për çadrat e diellit duhet ti përmbahen atyre të paraqitura në Lidhjen A.

Neni 23 - Lojërat për fëmijë

1. Lojëra për fëmijë do të konsiderohen strukturat komplekse, lehtësisht të çmontueshme, me sipërfaqe të fortë dhe lartësi maksimale 2.2 m nga trualli, që shërbejnë për të luajtur fëmijët e vegjël deri në moshën 12 vjeç.
2. Struktura duhet të jetë e fiksuar në truall për çështje sigurie, por pa prishur shtresat e hapësirës publike përreth dhe lehtësisht e çmontueshme. Struktura duhet të jetë brenda hapësirës së lejuar dhe nuk duhet të ndërhyjë në kurorën e pemëve.
3. Lojërat për fëmijë të përdorura në hapësirën publike duhet të kenë specifikime teknike dhe certifikatë sigurie me qëllim që të jenë të sigurt për fëmijët që do t'i përdorin.
4. Kur ato janë të vendosura në një sipërfaqe të fortë, të përdoret një shtresë në formë tapeti me sipërfaqe të butë për rritjen e sigurisë tek fëmijet për raste demtimi.
5. Tapeti i butë mbrojtës duhet të sigurojë parametrat termike, parametrat e zbutjes së goditjeve, të jetë material higjienik etj, ku të jenë të përcaktuara në specifikimet teknike të materialit të përdorur. "
6. Subjekti mban përgjegjësi për mirëmbajtjen periodike dhe kontrollin teknik të pajisjeve gjatë gjithë periudhës së përdorimit."

KREU II - DISTANCAT QË DUHET TË RESPEKTOHEN

Neni 24 - Distancat

1. Në këtë kre përcaktohen kriteret për mënyrën e vendosjes së pajisjeve në hapësirën publike dhe distancat që duhet të respektohen me qëllim ruajtjen e zonave lëvizëse të këmbësorëve dhe unifikimin e përdorimit të tyre. Distancat e paraqitura në vijim aplikohen në të gjitha format e zënies së hapësirës publike dhe pajisjet e lejuara me qëllim zhvillimin e aktiviteteve restorative dhe/ose rekreative.

2. Distanca e Frontazhit përcaktohet në raport me dimensionet e hapësirës publike duke garantuar gjithmonë:

a) Zonën Lëvizëse, e cila nuk mund të jetë me pak se 2.00 m;

b) Në gjitha rastet Frontazhi për subjektet nuk është me i vogël se 0.6 m dhe të gjithë elementët përbërës të tij (*si p.sh. karrige, tavolina, etj*) nuk duhet të kalojnë këtë distancë si dhe të respektojnë kushtet e përcaktuara në Vkm 224 datë 01.04.2026.

3. Gjatësia e shtrirjes së frontazhit shtrihet jo më shumë se fasada e objektit ku subjekti ushtron aktivitetin.

Në rast se në momentin e aplikimit paraqitet edhe dakordësia noteriale e pronarëve të pronave bashkëngjitur për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet përdorimi i hapësirës publike, duke përcaktuar hapësirën e hyrje/daljes, frontazhi mund të shtrihet edhe në gjatësinë e fasadës së këtyre pronave, por në çdo rast jo më shumë se 50 m për një subjekt.

KREU III - EKSPOZIMI I MALLRAVE JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT

Neni 25 - Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

1. Në këtë kre përcaktohen rregullat për mënyrën e ekspozimit të mallrave jashtë njësisë së tregtimit dhe pajisjen e tregtarëve me lejen përkatëse, me synim lehtësimin e aksesit të klientëve, gjallërimin e jetës urbane dhe përdorimin e kontrolluar të hapësirës publike.

2. Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë aktivitetin e tij të ekspozimit të mallrave jashtë njësisë së tregtimit duhet që të pajiset me kontratën përkatëse sipas sipërfaqes së deklaruar nga subjekti.

3. Ekspozimi i mallit jashtë njësisë së tregtimit pa lejen/kontratën përkatëse do të konsiderohet shkelje dhe mbi subjektin do të merren masa sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

4. Shfrytëzimi i hapësirës publike për këtë qëllim duhet të kryhet në përputhje me standartet e sigurisë dhe estetikës urbane, duke respektuar lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe pa çënuar integritetin funksional të hapësirës publike.

Për kategoritë e mallrave Fruta – perime, subjektet duhet ti përmbahen tipologjive të përcaktuara në Aneksin A.

KREU IV – PARKIMET E AUTOMJETEVE

Neni 26 - Krite mbi Parkimet e Rezervuara të automjeteve

1. Bashkia Shkodër në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, miraton hartën e parkimeve (zonave të lejuara) që mund të rezervohen në hapësirën publike të qytetit në aktet e miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Vendndodhja e tyre mund të përcaktohet edhe në Planet e Lëvizjes së Qëndrueshme Urbane, në Planet e Detajuara Vendore ose në dokumentat e tjera të planifikimit që miratohen nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me akte ligjore dhe nënligjore që normojnë zhvillimin dhe planifikimin e territorit.

2. Sinjalistika vertikale e parkimit duhet të ketë një tabelë vertikale me logon “P” të bardhë një katror blu, me emrin e subjektit, ditët dhe orarin përkatës. Tabela duhet të ketë përmasat 50 x 80cm dhe të jetë e vendosur në lartësinë 200 cm nga niveli i trotuarit. Pozicionimi i fiksimit në terren duhet të jetë 60 cm nga bordura e trotuarit.

3. Sinjalistika horizontale duhet të jetë vijëzimi me të verdhë ku vija të jetë me trashësi 10 cm.

4. Orari i rezervuar të jetë minimalisht 12 ore dhe i pa ndarë në fasha orare. Fashat oraret të cilat do jenë pjesë e kërkeses së subjekteve/individëve propozohen të jenë :

a) 08.00-20.00

b) 20.00-08.00

5. Fashat orare e propozuara sipas pikes 4 nuk janë kushtezuese por detyruesisht duhet të jenë të pandara në 12 ore.

6. Elementet (tabelat të cilat do vendosen), vijëzimi kostot merren në ngarkim nga subjekti/individi i cili kërkon vendrezervimin sipas specifikimeve të mëposhtme në bashkëpunim dhe monitorim të strukturës përgjegjëse të shërbimeve publike.



7. Në tabelën ilustruese të parkimit nuk lejohen reklama apo shënime të tjera veç atyre të përcaktuara ku përfshihen ditët , orarin , emrin e subjektit dhe numrin e vendeve. Në rast mosrespektimi të këtyre kriterëve për tabelat, do merren masa nga strukturat përgjegjëse të kontrollit si Policia Bashkiake për heqjen e tyre.

8. Kategoria e automjeteve të cilat lejohen për parkim të rezervuar janë automjetet (autovetura).

9. Përcaktimi i zonave të parkimit me regjim të vecantë kohor , tarifor dhe strategjik.

Përcaktimi i zonave të detinuara për parkim publik me regjim të vecantë kohor dhe strategjik me fasha orare specifike, sipas nevojave të administrimit të territorit dhe organizimit të qarkullimit, bëhet me vendim të titullarit të institucionit të Bashkisë Shkodër.


Cdo ndryshim tarifor për zona të vecanta parkimi kryhet me vendim të Këshillit Bashkiak.



KREU V – PARKIMET E BIÇIKLETAVE

Neni 27 - Krite mbi vendosjen e Parkimeve të Biçikletave

1. Në këtë kre të rregullores përcaktohen rregullat për vendosjen e parkimeve të biçikletave në hapësirat publike të Bashkisë Shkodër.
2. Parkimet e biçikletave duhet të jenë të parafabrikuar dhe me strukturë të qëndrueshme, por të cilat në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë hapësirën publike në të cilat vendosen dhe hapësirën përreth saj.
3. Parkimet e biçikletave duhet ti përmbahen me përpikmëri modelit, dimensioneve dhe materialeve të përcaktuara në Aneksin A. Në rastin e subjekteve në afërsi të njeri-tjetrit që kërkojnë të vendosin parkime, ato do të grupohen dhe vendosen në seri me njëri-tjetrin.
4. Nuk lejohet vendosja e asnjë elementi reklamues parkimet e biçikletave.
5. Parkimet e biçikletave duhet të jenë me përdorim të lirë publik, pavarësisht subjektit që merr autorizimin dhe i vendos ato.
6. Parkimet e biçikletave lejohen vetëm në rastet e trotuareve me elementeve urbane (pemë, stola etj) me gjerësi të trotuareve jo më të vogël se 4.50m. Struktura e parkimit nuk duhet të kalojë limitin 1.5m nga bordura e trotuarit. Parkimi bashkë me biçikletat nuk duhet të kalojnë limitin 2.0m nga bordura e trotuarit, në mënyrë të tillë që të sigurohet në çdo rast që edhe në pikun e përdorimit të mos cenohet zona lëvizëse prej 2.5m e trotuarit



Neni 28 - Autorizimi dhe procedura e dhënies së tij

1. Çdo subjekt apo individ që kërkon të vendosë parkim bicikletash përpara njësisë së tregtimit duhet që të pajiset me një autorizim të lëshuar nga Bashkia Shkodër.
2. Çdo parkim biçikletash i vendosur pa autorizimin përkatës të Bashkisë Shkodër do të konsiderohet shkelje dhe mbi subjektin do të merren masa ndëshkuese.
3. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë aplikimin në seksionin përkatës të portalit “ *e-Albania*”, ku duhet të ketë bashkangjitur:
 - a) Kërkesë për aplikim sipas formularit tip;
 - b) Genplanin që pasqyron gjendjen ekzistuese dhe atë të propozuar, i pajisur me legjendën përkatëse dhe i integruar në kontekstin urban;
 - c) Planimetrinë, pamjet dhe prerjet e projektit, të firmosura dhe të vulosura nga projektues të licencuar;
 - ç) Licencën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale të projektuesit të dokumentacionit teknik;
 - d) Fotografitë e gjendjes ekzistuese, ku paraqitet qartë konteksti urban;
 - dh) Vizualizime grafike (rendera) të projektit të propozuar;
 - e) Dokumentin që provon pronësinë ose qiranë e objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomik;
 - ë) Dokumentin e identifikimit të subjektit (NIPT).
 - f) Vendimin që subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara ndaj administratës.
4. Struktura përgjegjëse kryen vlerësimin paraprak të dokumentacionit.

KREU VI - DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29 - Dispozita kalimtare

1. Deri në krijimin dhe nisjen e funksionimit të Regjistrat Elektronik Unik, kërkesat për leje, sipas kësaj rregulloreje, mund të paraqiten edhe nëpërmjet depozitimit të tyre dhe dokumentacionit shoqërues fizikisht pranë ambienteve të zyrës me një ndalesë Z1N të Bashkisë Shkodër.
2. Kjo rregullore zbatohet në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 224 datë 01.04.2026. Për çdo çështje që nuk është parashikuar ose nuk është rregulluar në mënyrë të veçantë në këtë rregullore, zbatohen dispozitat e VKM-se nr. 224 datë 01.04.2026, dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 30 - Hyrja në fuqi



Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

LIDHJA A


Neni 1 - Përcaktime mbi çadrat e diellit që lejohen

Format e Lejuara te Çadrave:

Tipi 1 – E varur, me krah



Tipi 2 – E varur doppio, me krah T



Ngjyrat e lejuara te Strukturës së Çadrës:

 RAL 9010

 Antracite

 Ngjyre Druri

Ngjyrat e lejuara te Pëlhurës së Çadrës:

1 – Bardhe

2 – Pana

3



4 – Gjelbër




5 - Kuqe Bordeaux



Shembuj Çadrash te Lejuara qe plotësojnë Kërkesat:





Neni 2 - Përcaktime mbi tendat me strehë dhe tendat diellore që lejohen

Materialet e Strukturës duhet të jenë prej druri, hekuri dhe/ose alumin i ngjyrosur; me ngjyrat si më poshtë:



Materialet e tendës duhet të jenë pëlhurë beze, pëlhurë akrilike, pvc; me ngjyrat e lejuara si më poshtë:

1 – Bardhe



2 – Pana



3 – Gri e Erret




4 – Gjellbër



5 - Kuqe Bordeaux



Këto përcaktime të ngjyrave dhe materialeve të pëlhurës dhe strukturës vlejnë për të gjithë territorin e miratuar të hapësirës publike të miratuar nga KKTU, përveç zonave kryesore urbane me rëndësi historike dhe turistike që janë me vendim nga titullari i institucionit të Bashkisë Shkodër.






SHËNIME:

- Të gjitha dimensionet janë të përafërta
- Për mësim mund të ndryshojë sipas nevojave të projektit.
- Për mësim rekomandohet 30°-35° për kulimin e ujit.

PËRMASAT KRYESORE

Gjerësia totale	300 cm
Dalja (projeksioni)	170 cm
Lartësia paneli frontal	40 cm
Lartësia nga trotuari deri në fund të tendës	230 - 250 cm
Lartësia e montimit në mur	300 - 320 cm
Pjerrësia	30° - 35°



PËRMASAT KRYESORE

Gjerësia totale	150 cm
Dalja (projeksioni)	120 cm
Lartësia totale e harkut	80 cm
Lartësia e lirë poshtë tendës	200 - 230 cm
Materiali i konstruksionit	Metal (kornizë)
Mbulesa	Akrilik / PVC i tensionuar
Ngjyra	Sipas zgjedhjes

SHËNIME:


- Përmasat janë të përafërta dhe mund të përshtaten sipas nevojave të projektit.
- Konstruksion metalik i galvanizuar i lyer me bojë elektrostatische.
- Mbulesë akrilike rezistente ndaj rrezeve UV dhe kushteve atmosferike.
- Fiksimi në mur me konzola të dekoruara si në foto.

FOTO ILUSTRUESE



Neni 4 - Ekspozitorë produktesh ushqimore


Tipi 1



Materiali: Strukturë metalike me ngjyrë të zezë (Ral 9005), me seksion rrethor 1.5 x 1.5 cm. Arka druri për vendosjen e produkteve.

Dimensionet: lartësia 120 cm, gjatësia 55cm, gjërësia 32cm.


Tipi 2



Materiali: Strukturë metalike me ngjyrë të zezë (Ral 9005), me seksion rrethor 1.5 x 1.5 cm. Arka druri për vendosjen e produkteve.
Dimensionet: lartësia 120 cm, gjatësia 110 cm, gjërësia 32cm.

Neni 5 - Modele ekspozitorë veshje

Materiali: Strukturë metalike ngjyrë e zezë, me seksion rrethor 1.0 x1.0 cm i kombinuar sipas rastit me material dru (struktura ilustruese të ndryshme)



Neni 6 - Biçikletat

Model A – Dimensionimet e Vendqendrimit

